

 Republika e Kosovës Republika Kosovo	ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA OSOBLJA		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.56/17	Data: 24.04.2017	

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 12, paragrafi 4, të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Komuna e Istogut shpall :

KONKURS

Për kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

Drejtoria: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

Vendi i punës : Zyrtar për siguri të përgjithshme

Lloji i pozitës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (kohëzgjatja 5 muaj, me mundësi vazhdimi)

Numri i ekzekutuesve: 1(një)

Orari i plotë: 40 orë në javë

Paga: 350 €

Detyrat dhe Përgjegjësit:

- Të përcjell zhvillimet teknologjike nga sfera e siguris;
- Planifikon dhe paraqet kërkesat për ndërmarrjen e masave të sigurisë së përgjithshme në tërë teritorin e Komunës;
- Planifikimi dhe koordinimi i aktiviteteve me sektorin privat;
- Nga lamia e Sigurisë së Përgjithshme, zbaton Ligjin, Rregulloret dhe Vendimet me të cilat rregullohet ajo çështje nga fushë-veprimi i saj;
- Bashkërenditë aktivitetet në përgatitjen dhe jetësimin e masave që kanë të bëjnë me Sigurinë e Përgjithshme;
- Në bashkëpunim me zyrtarët tjerë dhe Oficerët e Policisë harton planin për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të kamerave;
- Ofron ndihmë profesionale organizatave shoqërore dhe private në hartimin e planeve të monitorimit të hapësirës me kamera dhe
- Bënë kontrollimin e plotësimit të planeve dhe zbatimit të tyre në këto organizata.

Kualifikimet e nevojshme:

- Diplomë e shkollës së mesme.
- Përvoja e preferueshme

Paga: 350 €

Afati i konkursit : Konkursi është i hapur tetë (8) ditë kalendarike nga data 24.04.2017 e gjer me datën 01.05.2017.

Dokumentet e kërkuara : Diploma mbi kualifikimin, nëse ka dëshmi për përvojën e punës, dokumenti i identifikimit, ekstrakti i lindjes.

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Zyrën e Personelit, kati i III-të, Zyra 304 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë "

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen



Menaxheri i Personelit
Fatmir Bytyçi